



Primer / Perzuar Number / Pradate Received / Delivery	18.02.2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Org / Agencija Org / Inst	No / Prot Br / Prot Prot No	Shtesa Puleg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	713/2021		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.428/2020**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.428/2020 të datës 21.12.2020 të parashtruar nga ankuesja, nga Fshati Koretin, në Komunën e Kamenicës, kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.02.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ** i filluar ma ankesën me numër A.nr.428/2020, e datës 21.12.2020 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja, e punësuar ne Qendrën e Mjekësisë Familjare ne Komunën e Kamenicës, sipas Akt emërimit me numër protokollit 02-23567 të datës 06.08.2019 në pozitën udhëheqëse e Sektorit të shëndetësisë, me datë 28.08.2019 me vendim me numër 02-26636 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, ka pezulluar marrëdhënien e punës në Komunën e Kamenicës nga pozita „ Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë”, për shkak të emërimit politik si asambleiste komunale.

Ankuesja me datë 23.10.2020 i është drejtuar U.D Drejtorit të QKMF në Kamenicë, përmes shkresës-kërkesës me numër Nr.02/23821, me te cilën ka kërkuar që në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik ti ndryshohet statusi i punës nga shërbyes civil ne nëpunës publike.

U.D. Drejtorit të QKMF në Kamenicë me datë 17.11.2020 i kthen përgjigje në kërkesën me numër Nr.02/23821 të datës 23.10.2020 me të cilin është shpallur jo kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën e ankueses. Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 17.11.2020 të U.D. Drejtorit të QKMF në Kamenice, me datë 21.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 3240/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 24.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Kamenicës. Më datë 08.01.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Kamenicës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me qëllim të vendosjes meritore lidhur me kërkesën e ankueses, me datë 10.02.2021 ka kërkuar informata shtesë nga organi i punësimit, dhe me datë 10.02.2021 ka pranuar provat shtese nga Komuna e Kamenicës, lidhur me kërkesën e ankueses.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3240/2020 të datës 21.12.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e datës 16.11.2020; Vendimi për pezullimin e marrëdhënies së punës së ankueses i datës 28.08.2019; Emali zyrtar i datës 17.04.2019; Kërkesa e datës 23.10.2020; Pliko postare R 1306391; Kërkesa për përgjigje e datës 24.12.2020; Përgjigja në kërkesës e datës 08.01.2021; Vendimi i KPMSHCK-se për vazhdimin e afatit i datës 04.02.2021; Emali i datës 03.02.2021; Emali zyrtar i datës 14.01.2021; Emali zyrtar i datës 10.02.2021 se bashku me tabelën që Zyra e Personelit – Komuna e Kamenicës e ka dërguar në MPB për deklarim të statusit të zyrtareve publike; Akt emërimi i ankueses i datës 06.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ne baze të dëshmimeve të ofruara ka konstatuar se ankuesja, bazuar në nenin 83 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrarëve Publik, datë 23.10.2020 i është drejtuar U.D Drejtorit të QKMF në Kamenicë, përmes shkresës-kërkesës me numër Nr.02/23821, me të cilën ka kërkuar që ti bëhet deklarimi i statusit të punësimit respektivisht ti ndryshohet statusi i punës nga shërbyes civil në nëpunës publike,

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmisë zyrtare gjegjësisht listës – tabelës për deklarim të statusit të zyrtareve publike që Zyra e Personelit e Komunës së Kamenicës e ka dërguar me datë 17.11.2020 në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka konstatuar që në këtë listë është e përfshirë edhe ankuesja

Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke marr parasysh pretendimet ankimore të ankueses lidhur me ndryshimin e statusit të punës nga shërbyes civil në nëpunës publike, dhe pasi që në bazë të dëshmimeve të pranuar nga organi i punësimit gjegjësisht „listës së klasifikimit”, ka konstatuar se Institucioni i punësimit, respektivisht Zyra e Personelit nga Komuna e Kamenicës me datë 17.11.2020 e ka dërguar listën– tabelën me të gjithë të punësuarit për deklarim të statusit të zyrtareve publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku në këtë listë është përfshirë edhe ankuesja

Andaj „Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar që „Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë” ka konstatuar që janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e parashtruar nga ankuesja

sepse në rastin konkret pretendimet e ankueses janë përmbushur apo realizuar duke marr parasysh faktin se Komuna e Kamenicës e ka dërguar listën e të gjithë punëtorëve të saj në DMZP-MPB për deklarimin e statusit të nëpunësve të saj se bashku me emrin e ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se DMZP-MPB pas pranimit të dokumentacionit përkatës nga institucionet e administratës shtetërore është e obliguar që të vendose për *deklarimin e statusit të punësimit* në përputhje me nenin 4 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrarëve Publikë, ndërsa kundër vendimeve për deklarimin/rregullimin e statusit, mund të parashtrohet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 8 të Rregullore (Qrk) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: „Kundër vendimeve për deklarimin/rregullimin e statusit, sipas kësaj Rregullore mund të parashtrahet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ në pajtim me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative”, rrjedhimisht nga kjo ankueses i njihet e drejta për ankesë në rast se ajo konsideron se i janë shkelur të drejtat e saj pas deklarimit të statusit të punësimit nga DMZP.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.428/2020

*Hysni Mustafa*

*Procesmbajtës*

*Malsore GASHI BAJRAKTARI*

*Kryetare e Kolegjit*



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.